

 Zyra e Guvernatorit Kabinet Guvernere Governor's Office	
E Dërguar: Prodator: Send to: <i>DI KOST. DI KAVAR FV</i>	
Data: Titulli: Data: <i>30-09-2019</i>	Nr: Br: No: <i>05-06-2019</i>

Bazuar në nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.17, dhe nenin 70 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me nenet 86 dhe 115 të Ligjit Nr.04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, nenin 130 të Ligjit 05/L-045 për Sigurimet, dhe nenin 6, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, të Ligji Nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 mars 2019, miratoi këtë:

Udhëzim

për tarifatat e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi dhe rregullimi i tarifave që Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) aplikon ndaj subjekteve që aplikojnë për licencim/regjistrim, institucioneve financiare që i rregullon dhe mbikëqyr, si dhe subjekteve që përdorin sistemet dhe shërbimet e ofruara nga BQK.
2. Ky udhëzim zbatohet për subjektet që aplikojnë për licencim/regjistrim në BQK, institucionet financiare të rregulluara dhe mbikëqyrura nga BQK dhe subjektet që përdorin sistemet dhe shërbimet e ofruara nga BQK.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë udhëzim kanë kuptim të njëjtë sikurse janë përcaktuar në Ligjin Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Ligjin Nr. 05/L-045 për Sigurimet, Ligjin Nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave dhe Ligjin Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale, si dhe për qëllimet e këtij udhëzimi si në vijim:
 - 1.1. **Tarifë** – nënkupton vlerën financiare që BQK-ja iu ngarkon subjekteve që aplikojnë për licencim/regjistrim, institucioneve financiare që i rregullon dhe mbikëqyrë, si dhe subjekteve që përdorin sistemet dhe shërbimet e ofruara nga BQK-ja.

Neni 3

Llojet e tarifave

1. BQK-ja i ngarkon subjektet që aplikojnë për licencim/regjistrim, institucionet financiare që i rregullon dhe mbikëqyr si dhe subjektet që përdorin sistemet dhe shërbimet e ofruara nga ana e saj, me llojet e tarifave të grupuara si në vijim:
 - 1.1. Grupi I –Tarifat për licencim/regjistrim;
 - 1.2. Grupi II –Tarifat për miratimin e transaksioneve të institucioneve financiare që kërkojnë miratim paraprak nga BQK;
 - 1.3. Grupi III –Tarifat për mbikëqyrje;
 - 1.4. Grupi IV –Tarifat për operacionet me llogaritë rrjedhëse dhe artikujt në ruajtje në BQK;
 - 1.5. Grupi V –Tarifat për operacionet me letra me vlerë;
 - 1.6. Grupi VI –Tarifat për sistemin e pagesave ndërbankare;
 - 1.7. Grupi VII –Tarifat për Regjistrin e Kredive të Kosovës;
 - 1.8. Grupi VIII –Tarifat për Regjistrin e Llogarive Bankare;
 - 1.9. Grupi IX –Tarifat speciale për projekte të veçanta.

Neni 4

Tarifat për licencim/regjistrim dhe për miratim të transaksioneve të institucioneve financiare që kërkojnë miratim paraprak nga BQK

1. Subjektet që kërkojnë të licencohen/regjistrohen nga BQK si institucione financiare do të paguajnë tarifë për licencim/regjistrim në BQK, për shqyrtim të aplikacionit/kërkesës.
2. Institucionet financiare të licencuara/regjistruara nga BQK që kërkojnë miratim paraprak për transaksionet të cilat sipas legjislacionit në fuqi duhet të miratohen nga BQK, do të paguajnë tarifën për miratimin e transaksioneve të institucioneve financiare, për shqyrtim të kërkesës për miratim.
3. Dëshmia për pagesën e tarifave sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni është pjesë përbërëse e dokumentacionit mbështetës të kërkesës për licencim/regjistrim apo miratim.
4. Pagesat e tarifave sipas këtij neni janë obligative dhe nuk janë të kthyeshme.
5. Vlera e tarifave sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni është fikse sikurse përcaktohen në Listën e Tarifave të BQK-së, Grupi I dhe II.

Neni 5

Tarifat për mbikëqyrje

1. Institucionet financiare do të paguajnë tarifën e mbikëqyrjes për BQK-në në varësi të veprimtarisë financiare të cilën e ushtrojnë. Elementet në të cilat bazohet kalkulimi i tarifës së mbikëqyrjes, janë si më poshtë:
 - 1.1. Tarifa e mbikëqyrjes për bankat bazohet në përqindjen fikse të gjithsej mjeteve të bankës, varësisht nga klasifikimi i bankës nga ekzaminimi i fundit i BQK-së. Në rastet e degëve të bankave të huaja kjo tarifë aplikohet mbi bazën e gjithsej mjeteve që ka dega në Kosovë, varësisht nga klasifikimi i degës së bankës së huaj nga ekzaminimi i fundit i BQK-së.
 - 1.2. Në rastet kur banka apo dega e bankës së huaj nuk është e vlerësuar nga BQK, atëherë në kalkulimin e kësaj tarife aplikohet përqindja fikse në gjithsej mjetet e bankës apo degës së bankës së huaj në Kosovë.
 - 1.3. Tarifa e mbikëqyrjes për siguruesit dhe degët e siguruesve të huaj të licencuar nga BQK-ja, aplikohet si përqindje fikse të primeve bruto të shkruara, varësisht nga klasifikimi i siguruesit nga ekzaminimi i fundit i BQK-së. Në rastet e degëve të siguruesve të huaj kjo tarifë aplikohet si përqindje fikse të primeve bruto të shkruara që ka dega në Kosovë, varësisht nga klasifikimi i degës së siguruesve të huaj nga ekzaminimi i fundit i BQK-së.
 - 1.4. Në rastet kur siguruesi apo dega e siguruesve të huaj nuk është e vlerësuar nga BQK, atëherë në kalkulimin e kësaj tarife aplikohet përqindja fikse e primeve bruto të shkruara të siguruesi apo dega e siguruesve të huaj në Kosovë.
 - 1.5. Tarifa e mbikëqyrjes për Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), fondeve tjera pensionale dhe menaxhuesve të mjeteve pensionale, aplikohet si përqindje fikse e gjithsej të hyrave të tyre.
 - 1.6. Tarifa e mbikëqyrjes për institucionet mikrofinanciare, aplikohet si përqindje fikse mbi gjithsej portofolin nga aktiviteti i kredidhënies.
 - 1.7. Tarifa e mbikëqyrjes për institucionet financiare jobankare që ushtrojnë veprimtari të kredidhënies, qirasë (lizingut), garancisë, faktoringut dhe/apo veprimtarive tjera financiare që kanë portofolio aplikohet si përqindje fikse mbi gjithsej portofolion nga këto aktivitete.
2. Të gjitha institucionet financiare që nuk paguajnë tarifë të mbikëqyrjes mbi bazën e elementeve të kalkulimit të përcaktuar në nënparagrafët 1.1 deri 1.7 të paragrafit 1 të këtij neni, paguajnë një tarifë fikse mbi bazë tremujore apo vjetore ashtu siç është e përcaktuar në Listën e Tarifave të BQK-së, Grupi III.
3. Institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare që njëkohësisht ushtrojnë veprimtari sipas nënparagrafëve 1.6 dhe 1.7 të paragrafit 1 të këtij neni, si dhe veprimtari për të cilat aplikohet tarifë fikse e mbikëqyrjes sipas paragrafit 2 të këtij neni, përveç tarifës sipas nënparagrafëve 1.6 dhe 1.7 të paragrafi 1 të këtij neni duhet të paguajnë edhe tarifën fikse sipas paragrafit 2 të këtij neni.
4. Tarifat e mbikëqyrjes të përcaktuara sipas paragrafëve 1, 2 dhe 3 të këtij neni nuk mund të jenë më të vogla se sa minimumi i përcaktuar në Listën e Tarifave të BQK-së, Grupi III, aty ku është i aplikueshëm minimumi.

5. Tarifa e mbikëqyrjes së institucioneve financiare sipas këtij neni aplikohen në baza tremujore dhe vjetore siç përcaktohet në Listën e Tarifave të BQK-së, Grupi III.
6. Në rastet kur një institucion financiar licençohet/regjistrohet në gjysmën e parë të periudhës për të cilën kalkullohet tarifa e mbikëqyrjes, ai institucion duhet të paguaj tarifën e plotë të mbikëqyrjes sipas përcaktimeve të këtij neni, për atë periudhë.
7. Në rastet kur një institucion financiar licençohet/regjistrohet në gjysmën e dytë të periudhës për të cilën kalkullohet tarifa e mbikëqyrjes, ai institucion fillon të paguaj tarifën e mbikëqyrjes sipas përcaktimeve të këtij neni, nga periudha e pasuese e kalkulimit të kësaj tarife.

Neni 6

Tarifat për operacionet me llogaritë rrjedhëse dhe artikujt në ruajtje në BQK

1. Institucionet financiare, subjektet publike dhe pjesëmarrësit tjerë në sistemin e pagesave do të paguajnë tarifa për operacionet me llogaritë rrjedhëse dhe artikujt në ruajtje si në vijim:
 - 1.1. Mirëmbajta e llogarive;
 - 1.2. Transferet vendore;
 - 1.3. Transferet ndërkombëtare;
 - 1.4. Transaksionet me para;
 - 1.5. Operacionet me artikujt e lënë në ruajtje;
 - 1.6. Operacionet specifike për Ministrinë e Financave – Thesarin dhe FKPK;
 - 1.7. Operacionet specifike për institucionet financiare ndërkombëtare.
2. Tarifat nga nënparagrafi 1.1 deri tek nënparagrafi 1.4 të paragrafit 1 të këtij neni do të paguhen sipas vlerës së përcaktuar në Listën e Tarifave të BQK-së, Grupi IV.
3. Tarifat nga nënparagrafi 1.5 deri tek nënparagrafi 1.7 të paragrafit 1 të këtij neni përcaktohen dhe paguhen sipas vendimit të veçantë të Bordit Ekzekutiv të BQK-së.

Neni 7

Tarifat për operacionet me letra me vlerë

1. Institucionet financiare në rolin e akterëve primarë, pjesëmarrësve primarë dhe investitorëve në tregun primar dhe sekondar të letrave me vlerë do të paguajnë tarifa për operacionet me letra me vlerë, si në vijim:
 - 1.1. Për pjesëmarrje dhe shfrytëzim të Sistemit Elektronik të Regjistrimit Kontabël për Letrat me Vlerë të Qeverisë DEPO/X;
 - 1.2. Për regjistrim/qasje të enkriptuar si pjesëmarrës të Sistemit Elektronik të Regjistrimit Kontabël.
2. Tarifat nga paragrafi 1 i këtij neni do të paguhen sipas vlerës së përcaktuar në Listën e Tarifave të BQK-së, Grupi V.

Neni 8

Tarifat për sistemin e pagesave ndërbankare

1. Bankat dhe pjesëmarrësit tjerë në sistemin e pagesave do të paguajnë tarifa për sistemin e pagesave ndërbankare si në vijim:
 - 1.1. Për pjesëmarrje në sistemin e pagesave ndërbankare;
 - 1.2. Për pagesat e rregullta – ACH (deri në vlerën 10 mijë Euro);
 - 1.3. Për pagesat – RTGS (të rregullta mbi 10 mijë Euro dhe prioritare);
 - 1.4. Për pagesat masive – ACH;
 - 1.5. Pagesat Paga dhe Pensione – ACH;
 - 1.6. Pagesat Xhiro (KOS-GIRO) – ACH;
 - 1.7. Pagesat debitim direkt – ACH;
 - 1.8. Kërkesat dhe raportet.
2. Për transaksionet e dërguara në periudha të caktuar kohore brenda ditës, do të aplikohen tarifa të niveleve të ndryshme për llojet e njëjta të transaksioneve varësisht nga periudha e kryerjes së transaksionit, sipas Listës së Tarifave të BQK-së, Grupi VI.
3. Tarifat nga paragrafi 1 i këtij neni do të paguhet sipas vlerës së përcaktuar në Listën e Tarifave të BQK-së, Grupi VI.

Neni 9

Tarifat për Regjistrin e Kredive të Kosovës

1. Institucionet financiare kredidhënëse do të paguajnë tarifa për Regjistrin e Kredive të Kosovës (RKK) si në vijim:
 - 1.1. për pjesëmarrje në RKK;
 - 1.2. hulumtimet e informacioneve;
 - 1.3. kërkimet (pyetjet) dhe ndryshimet e të dhënave të gabuara.
2. Subjektet e të dhënave do të paguajnë tarifë fikse për raportin kreditor personal.
3. Tarifa nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni do të paguhet sipas vlerës së përcaktuar në Listën e Tarifave të BQK-së, Grupi VII.

Neni 10

Tarifa për Regjistrin e Llogarive Bankare

1. Bankat, për raportimin e llogarive në Regjistrin e Llogarive Bankare (RLLB), organet përmbaruese sipas Ligjit për Procedurën Përmbarimore dhe institucionet tjera pjesëmarrëse në këtë sistem, për shfrytëzimin e RLLB-së, do të paguajnë tarifë, si në vijim:
 - 1.1. Pjesëmarrja e bankave në RLLB;
 - 1.2. Mbajtja e llogarive në RLLB nga Bankat;
 - 1.3. Pjesëmarrja dhe shfrytëzimi i RLLB-së nga organet përmbaruese siç përcaktohen me Ligjin për procedurën përmbarimore dhe institucionet tjera të cilave ju sigurohet qasja në këtë regjistër në pajtim me rregulloren e BQK-së për Regjistrin e Llogarive Bankare.
2. Tarifa nga paragrafi 1 i këtij neni do të paguhet sipas vlerës së përcaktuar në Listën e Tarifave të BQK-së, Grupi VIII.

Neni 11

Tarifat specifike për projekte të veçanta

1. Tarifa specifike për projekte të veçanta është tarifë që paguhet nga subjektet e mbikëqyrura për financimin e projekteve të veçanta dhe caktohen me vendim të veçantë të Bordit Ekzekutiv.
2. Nga projektet e veçanta përfitojnë subjektet e mbikëqyrura dhe të ardhurat nga këto tarifa përdoren vetëm për financimin dhe mirëmbajtjen e këtyre projekteve, sipas përcaktimeve të vendimit të Bordit Ekzekutiv.
3. BQK do të ngarkojë subjektet e mbikëqyrura me tarifë speciale në pajtim me marrëveshjet speciale në shumën dhe mënyrën e specifikuar në këto marrëveshje.

Neni 12

Vlera e tarifave

1. Vlera e detajuar e tarifave sipas këtij udhëzimi, është përcaktuar në Listën e Tarifave të BQK-së.
2. BQK rishikon vlerën e tarifave në varësi të zhvillimeve të tregjeve dhe nevojës për përmbushjen e detyrave dhe objektivave të saj.
3. Rishikimi i vlerës së tarifave në Listën e Tarifave të BQK-së bëhet nga Bordi Ekzekutiv i BQK-së.

Neni 13

Kalkulimi, faturimi dhe pagesa e tarifave

1. Subjektet dhe institucionet financiare paguajnë tarifën e përcaktuar me këtë udhëzim në llogari të BQK-së, sipas vlerave dhe përcaktimeve përkatëse në Listën e Tarifave të BQK-së.

2. Kalkulimi dhe/ose faturimi i tarifave bëhet nga departamenti përkatës varësisht nga grupi i tarifave, sipas afateve të përcaktuara në këtë nen.
3. Fatura për tarifën bëhet në tri kopje origjinale, një për institucionin/subjektin, një për Departamentin përkatës (lëshues të faturës), si dhe një për Departamentin e Planifikimit dhe Raportimit Financiar. Faturës për tarifën që kërkojnë kalkulim i bashkëngjitet edhe dokumenti i kalkulimit të vlerës së faturës përkatëse.
4. Për shërbimet e ofruara për të cilat aplikohet tarifë periodike sistemet përkatëse në kuadër të departamenteve të BQK-së, kur është e mundur, do të gjenerojnë faturën sipas standardit të BQK-së dhe të njëjtat do të dërgohet tek institucioni/pala përkatëse, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas përfundimit të periudhës për të cilën paguhet tarifa.
5. Për qëllime të këtij neni tarifa periodike nënkupton tarifën që aplikohet mbi baza të rregullta për periudha të caktuara kohore (në baza mujore, tre mujore, gjashtë mujore ose vjetore).
6. Për shërbimet tjera të ofruara për të cilat nuk aplikohet tarifë periodike departamentet përkatëse të BQK-së do të gjenerojnë faturën sipas standardit të BQK-së dhe të njëjtat do të dërgohet tek institucioni/pala përkatëse, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas pranimit të kërkesës për këto shërbime.
7. Për institucionet të cilat kanë llogari në BQK, të gjitha llojet e tarifave të përcaktuara me këtë udhëzim dhe të cilat aplikohen ndaj tyre, do të procedohen pas njoftimit të tyre, përmes debitimit direkt nga llogaria e tyre në BQK.
8. Tarifat për operacionet me llogaritë e klientëve në BQK aplikohen nga sistemi në mënyrë automatike me rastin e realizimit të transaksioneve;
9. Institucionet financiare të cilat nuk kanë llogari në BQK, tarifën e përcaktuara me këtë udhëzim do të paguhet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas pranimit të faturës.
10. Ankesat rreth faturës së lëshuar mund të paraqiten në BQK të Departamenti i Planifikimit dhe Raportimit Financiar jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e pranimit të faturës. Ankesa eventuale e paraqitur shtyn afatin e pagesës së përcaktuar në këtë nen.
11. Kur vërtetohet se ankesa lidhur me tarifën e lëshuar është e bazuar, dhe është pranuar brenda afatit të paraparë, BQK – Departamenti i Planifikimit dhe Raportimit Financiar do të lëshojë faturë të re për rastin përkatës e cila do të zëvendësojë faturën e lëshuar më parë, për këtë qëllim.

Neni 14

Masat administrative në rastet e mos pagesës së tarifave

1. Në rast të mospagesës së tarifave për aplikim për licencë/regjistrim, tarifave për kërkesat për miratimin nga BQK të transaksioneve të ndryshme të institucioneve financiare, apo tarifave për RKK nga subjektet e të dhënave, sipas afateve të përcaktuara në këtë udhëzim, aplikacionet e subjekteve për licencim/regjistrim si institucion financiar, kërkesat e institucioneve financiare dhe kërkesat e subjekteve nuk do të shqyrtohen nga BQK.

2. Në rast të mospagesës së tarifave tjera nga ato të përcaktuara në paragrafi 1 të këtij neni, sipas afateve të përcaktuara në këtë udhëzim, institucionet financiare mund të jenë subjekt i masave administrative të përcaktuara sipas kornizës ligjore në fuqi.
3. Për vonesat në pagesa të tarifave sipas paragrafit 2 të këtij neni, BQK mund të kalkulojë kamatëvonesë në pajtim me legjislacionin në fuqi.
4. Në rast të moskryerjes së obligimeve për kryerje të pagesës së faturës nga pjesëmarrësit në RLLB, BQK mund të ndërpres qasjen e përdorueseve të atij pjesëmarrësi në këtë regjistër.

Neni 15

Shtojcat

Pjesë përbërëse e këtij udhëzimi është Shtojca 1.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi më 1 korrik 2019.

Fehmi Mehmeti

Kryesues i Bordit Ekzekutiv

SHTOJCA 1.

FATURA PËR PAGESËN E TARIFAVE TË BANKËS QENDRORE



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Nga:

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Rruga Garibaldi 33,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel. +381 222 055; Fax. +381 38 343 763
Nr. Fiskal: **600104187**

DATË (dd/mm/vvvv): 27/07/2018
Fatura No.: 01_2018_aannnn
Referenca e Tarifës: BQTA019.01
KODI: BQTLBA01019
Referenca specifike: TA019.010118aannnn

Për:

Emri: "XYZ"
Adresa: Rr. "ABC"

Nr. Fiskal/ID: **600** _ _ _

Përshkrimi:	Shuma:
BQTLBA01019_XYZ_Fat.No._01_2018_aannnn (Tarifë)	€ 0.00
TOTAL:	€ 0.00

Analitikë e pagesës (përfituesi):

Emri: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Llogaria: 1000700010000136
Emri i llogarisë: BQK PAGESA VENDORE

Kopje:

Divizioni i Kontabilitetit dhe mbështetjes
Departamenti i Planifikimit dhe Raportimit Financiar

Elementet e Faturës:

1. Emri, adresa, informatat kontaktuese dhe numri fiskal – për institucionin që lëshon faturën,
2. Data e procesimit të faturës – e formatit “dd/mm/vvvv” (dd = dita, mm=muaji dhe vvvv = viti).
3. Numri serik i faturës – sipas njësive që lëshojnë faturën, formati “nn_vvvv_aannnn”,
 - a. nn – paraqet periodicitetin e faturës brenda vitit i shkruar si numër,
 - b. vvvv – paraqet vitin, dhe
 - c. aannnn – “aa” paraqet dy inicialet e para të njësive organizative dhe “nnnn” numrin serik ndërsa me numra
 - i. MS - Mbikëqyrja bankare,
 - ii. MS - Mbikëqyrja e sigurimeve,
 - iii. DL - Departamenti i Licencimit,
 - iv. SP - Sistemi i pagesave,
 - v. PM - Paraja dhe Marrëdhëniet bankare,
 - vi. RK - Regjistri i kredive, dhe
4. Referenca e Tarifës – praktikisht identifikimi specifik sipas listës, formati “BQTAnnn.nn”, (“BQ” – Banka Qendrore, “TA” - Tarifë, “nnn.nn” – tre “nnn” e parë përfaqësojnë llojin, ndërsa dy “nn”-të e fundit përfaqësojnë nënlojin që vlen në disa raste).
5. Kodi – paraqet kodin e të hyrave për qëllime të identifikimit specifik të të hyrave sipas qendrave shpenzuese, që paraqet një kombinim të llojit të tarifës dhe qendrave shpenzuese,
6. Referenca specifike – që ndërlidh numrin e faturës me referencën e tarifës, kjo po ashtu është për qëllime të identifikimit të llojit të tarifës dhe ndërlidhja e saj me faturën, praktikisht kjo mund të jetë edhe referenca që sipas standardeve kërkohet të përcjell një transaksion nga fillimi deri në fund të procesimit, pa marrë parasysh se ku është procesuar dhe ku ka destinacionin final.
7. Emri, adresa dhe nr. fiskal apo ID (numri personal) – për personin juridik apo fizik (për personin juridik duhet të plotësohet numri fiskal, ndërsa për personin fizik numri personal nga kartela e identifikimit apo pasaporta).
8. Përshkrimi – është i standardizuar “aaaaannnn_XYZ_Fat.No._nn_vvvv_aannnn”, dhe plotësohet automatikisht pasi të plotësohet numri i faturës dhe referenca e faturës,
 - a. “aaaaannnn” – Kodi i gjeneruar automatikisht si të përzgjidhet referenca, dhe përmban gjashtë (6) shkronja dhe pesë (5) numra
 - b. XYZ – emri i personit fizik apo juridik që i drejtohet fatura, dhe
 - c. Fat.No._nn_vvvv_aannnn – përshkrimi për numrin e faturës.
9. Shuma – e faturës, obligimi financiar për personin fizik apo juridik që i lëshohet fatura,
10. Analitikë e pagesës (përfituesi) – shënimet që identifikojnë përfituesin dhe llogarinë ku do të kreditohet pagesa (në këtë rast BQK-në) dhe
11. Përshkrimi se ku duhet dërguar informata si “kopje”, pasi është lëshuar fatura.